



Fundeli

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
MINISTRI

Nr. 6648 prot.

Tiranë, më 08.12.2022

UDHËZIM

Nr. 662, Datë 06 / 11 2022

“PËR

NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 689, DATË 2.10.2018, “PËR NIVELIN E KUOTAVE TË SHPENZIMEVE PËR USHQIME, NË INSTITUCIONET PUBLIKE REZIDENCIALE E KOMUNITARE TË PËRKUJDESJES SHOQËRORE”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 23, të ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” dhe në pikën 71, të kreut V, të Vendimit nr. 518, datë 4.9.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe për masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”,

Udhëzoj:

Në Udhëzimin nr. 689, datë 2.10.2018, “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Pas pikës 3, shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3.1. Ngarkohet Shërbimi Social Shtetëror për zbatimin e pikës 71, të Vendimit Nr. 518, datë 4.9.2018, të Këshillit të Ministrave “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, si edhe të planifikojë efektet financiare në zbatim të tij”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

